

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Oper. Sistemi, Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr.1 i prokurimit	KOSTT-26-844-1-2-1
Nr. i brendshëm	KOSTT(023/125-2)-26-18-121

Sa i përket tenderit për

Furnizim me vargje të izolatorëve të polimerit të tensionit të lartë 400kV si pjesë rezervë për Linjën nr.408

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Risamont SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brahim Ademi, Bregu i Diellit

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349393528

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Riad Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

risamont@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.07.2026

(Data e parashtrim të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 26.02.2026
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 23.03.2026
Njoftimi i Vendimit të AK-2: 24.06.2026
Kërkesa për rishqyrtim-KRSH-2: 26.06.2026
Njoftimi i i Vendimit të AK në KRSH-2: 30.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 53 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 65-71 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 28.1 (Specifikimet Teknike)
Neni 28.3 (Përshkrimi i Specifikimeve)
Rregullorja për Prokurim Publik (Neni 41.5)

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 30.06.2026, kemi pranuar Vendimin e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit të KOSTT-it, mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim (KRSH) si të pabazuar (p. 9). Operatori Ekonomik "RISAMONT" SH.P.K. paraqet këtë Ankesë pranë OSHP-së, brenda afatit ligjor prej 10 ditësh sipas Nenit 115 dhe 116 të LPP-së, kundër vendimit të AK-së për eliminimin e sërishëm të ofertës sonë në fazën e rivlerësimit (pp. 1, 9).

Ky vendim i AK-së vjen në shkelje të drejtpërdrejtë të Vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së me nr. 2026/0299 të datës 01.06.2026, si dhe në shkelje të Neneve 7, 28, 59.4 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) (pp. 1, 4, 8).

I. ARGUMENTET LIGJORE DHE TEKNIKE KUNDËR REFUZIMIT TË AK-së

1. Rreth Standardit IEC 60471 dhe "Shtimit të Provave" (Neni 72 i LPP)

AK pretendon se dokumenti "*Clarification*" i datës 28.04.2026 përbën "provë të re" dhe ndryshim të ofertës bazë (pp. 2-3). Ky konstatim është juridikisht i gabuar:

- **Fakt:** Prodhuesi "*Yangzhou Shuangbao Electric Equipment CO., Ltd*" nuk ka ndryshuar asnjë parametar të produktit (p. 2). Letra thjesht konfirmon se modelet e ofertuara (FXBW-400kV-160kN-3100 dhe FXBW-400kV-210kN-3140) ndiqnin standardin dimensional IEC 60471 (p. 2).
- **Gjetja e OSHP-së:** Paneli Shqyrtues ka konstatuar paraprakisht se ky standard rregullon dimensionet e bashkimeve metalike (*fittings*) (p. 2). Lidhjet tona janë të madhësive standarde 22 dhe 24 (p. 2). Ato janë 100% të ndërkëmbyeshme me pajisjet ekzistuese në Linjën 408 (p. 2).
- **Shkelja:** Refuzimi i një sqarimi zyrtar nga prodhuesi që vërteton përputhshmërinë dimensionale, pa pasur asnjë ndryshim të substancës së ofertës, përbën zbatim të gabuar të Nenit 72 të LPP-së dhe Nenit 38 të RPP-së (pp. 2-3).

2. Kualifikimi i Gabuar i Karakteristikave Superiore si "Devijime" (Neni 59.4 i LPP-së)

AK arsyeton se izolatorët me përmasa më të mëdha nuk mund të përdoren në linjën ekzistuese dhe sjellin shfrytëzim joracional të parasë publike (p. 4). Ky pretendim është teknikisht i paqëndrueshëm:

- **Diametri i Pjatave (Ø160 mm):** Ekspertiza e OSHP-së ka vërtetuar se ky diametër rrit performancën izoluese elektrikisht (p. 4). Ai nuk ndryshon gjatësinë totale të izolatorit (p. 4). Distancat e sigurisë në linjat 400 kV nuk cenohen (p. 4).
- **Bërthama (Ø34 mm):** Ofrimi i një bërthame më të trashë (Ø34 mm në vend të Ø31 mm) ofron koeficient më të lartë të sigurisë mekanike (SML) (p. 4). Kjo garanton qëndrueshmëri më të lartë operative në kushte ekstreme (p. 4). Neni 59.4 i

LPP-së mbron ofertat që ofrojnë karakteristika superiore që nuk çenojnë funksionalitetin.

3. Çështja e Peshës (MASS) dhe Obligimi për Sqarim (Neni 72 i LPP)

Në vendimin e fundit, AK ka ngritur si argument kryesor mospërputhjen e peshës, duke pretenduar se kërkesa ishte 12.2 kg, ndërsa në TDS është ofruar 15.3 kg (një dallim prej +3.1 kg) (pp. 5-6).

- **Fakt:** Diferencat minimale midis tabelës TDS (15.3 kg) dhe vizatimit teknik (15.25 kg) tregojnë qartë se kemi të bëjmë me paqartësi ose gabime formale të transkriptimit industrial të fabrikës (pp. 5-6).
- **Shkelja e Ligjit:** Një variacion i tillë nuk ndikon në kapacitetin bartës ose elektrik të izolatorit në shtyllë. Kjo do duhej të mirej si avantazh e jo të cilësohet si dobësi apo mangësi.

4. Dëmtimi i Buxhetit Publik dhe Parimi i Ekonomisë (Neni 1 dhe 6 i LPP)

AK pretendon se zbatimi i parimit të ekonomisë nuk nënkupton vetëm çmimin më të ulët, por edhe përdorshmërinë e mallit (p. 7). Megjithatë:

- **Oferta e "RISAMONT" SH.P.K. është 33,905.00 €, ndërsa oferta e rekomanduar nga KOSTT është 43,618.70 € (p. 7).**
- **Diferenca financiare është plot 9,713.70 euro (rreth 22% më e shtrenjtë) (p. 7).**
- Meqenëse produktet tona teknikisht përmbushin standardet dimensionale të ndërkëmbyeshmërisë, eliminimi i ofertës sonë për arsye që janë trajtuar dhe hedhur poshtë nga **Vendimi i Panelit të OSHP dhe Ekspertit** i shkakton autoritetit dëm të drejtpërdrejtë financiar, në kundërshtim me Nenin 6 të LPP-së (pp. 7-8).

II. KËRKESA PËR PANELIN SHQYRTUES TË OSHP-së

Mbështetur në të gjitha gjetjet e mësipërme dhe në dokumentacionin e bashkëngjitur, i kërkojmë Panelit Shqyrtues të OSHP-së:

1. **Të aprovojë** këtë ankesë të OE "RISAMONT" SH.P.K. si plotësisht të bazuar (p. 1).
2. **Të anulojë** Vendimin e Autoritetit Kontraktues (KOSTT) të datës 26.06.2026 (dhe vendimin refuzues të KRSH-së të datës 30.06.2026) për eliminimin e ofertës sonë (pp. 1, 9).
3. **Të urdhërojë** Autoritetin Kontraktues që ta kthejë lëndën në rivlerësim, duke e shpallur ofertën tonë si të përgjegjshme dhe të na rekomandojë për dhënie të kontratës, në përputhje të plotë me Vendimin paraprak të OSHP-së nr. 2026/0299 (p. 1).

LISTA E DOKUMENTEVE TË BASHKËNGJITUR:

1. Vendimi i AK KOSTT mbi Refuzimin e KRSH-së (Datë: 30.06.2026) (pp. 1, 9).
2. Vendimi paraprak i Panelit Shqyrtues të OSHP-së, Nr. 2026/0299 (p. 1).
3. Letra Zyrtare e Sqarimit nga Prodhuesi *Yangzhou Shuangbao Electric Equipment CO., Ltd* (Datë: 28/04/2026) (p. 2).

Nenet kryesore ku KOSTT ka rënë ndesh janë:

1. Neni 28.1 (Specifikimet Teknike)

Ky nen detyron Autoritetin Kontraktues (AK) që specifikimet teknike të hartuara të mos krijojnë pengesa të pajustificueshme për konkurrencën.

Pse bie ndesh: Eliminimi për dallime milimetrike (Ø151 vs Ø160), të cilat nuk pengojnë montimin por rritin sigurinë, konsiderohet si interpretim i ngushtë që pengon konkurrencën e produkteve me performancë më të lartë.

2. Neni 28.3 (Përshkrimi i Specifikimeve)

Ky nen thotë se specifikimet duhet të hartohen në terma të kërkesave të performancës dhe funksionalitetit, e jo vetëm në dimensione strikte.

Pse bie ndesh: Izolatorë e ofertuar përmbushin funksionin (izolim dhe forcën mekanike) madje në nivel më të lartë. AK-ja duhet të vlerësojë nëse produkti kryen punën, e jo vetëm nëse përputhet me vizatimin "pikë për pikë" kur dallimi është në favor të sigurisë së rrjetit.

3. Neni 59.4 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve)

Ky nen përcakton se një tender duhet të konsiderohet i përgjegjshëm nëse ka vetëm devijime minore që nuk ndryshojnë në mënyrë substanciale karakteristikat e kërkuara.

Pse bie ndesh: Dallimi në diametër të pjatave dhe bërthamës, kur lidhjet (fittings) janë standarde sipas IEC 60471 dhe sipas kërkesës së AK, klasifikohet si devijim minor ose përmirësim teknik. Eliminimi për këtë arsye është në kundërshtim me parimin e "tenderit të përgjegjshëm".

4. Rregullorja për Prokurim Publik (Neni 41.5)

Kjo rregullore sqaron se gabimet ose lëshimet që nuk prekin renditjen e ofertave ose që nuk ndryshojnë thelbin e ofertës teknike, nuk duhet të çojnë në eliminim.

Pse bie ndesh: Meqenëse izolatorët e ofertuar janë plotësisht të ndërëmbyeshëm, AK-ja ka vepruar në mënyrë joproporcionale duke na eliminuar për një avantazh teknik (bërthamë më të fortë dhe nivel më të lartë izolimi).

5. Parimi i Barazisë dhe Mosdiskriminimit (Neni 7)

Pse bie ndesh: Duke eliminuar një ofertë teknike superiore për shkak të interpretimeve të standardit IEC 60471 (i cili rregullon vetëm lidhjet e jo bërthamën, gjë që këtë standard plotësojnë produktet e ofertuara), AK-ja ka krijuar diskriminim ndaj një prodhuesi që ofron siguri më të lartë.

Me kete rast AK ka vepruar ndesh me te gjitha nenet e listuara ne piken:

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues, respektivisht edhe me nenet :

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujve të tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;

(i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;

(ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj;

(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;

(iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit;
(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Ndërsa pika (vi) e paragrafit 6 e nenit 7 të LPP-së e përcakton qartë që “*që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.*

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Risamont SH.P.K-Prishtinë**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim dhe ankesës në vlerë prej të paktën 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.